



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 28.07.2026

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Hartim Projekti “Plani i Mbarështimit të Pyjeve në Bashkinë Durrës”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Shërbimet e modelimit të projekteve 72242000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT:

3,586,370 (tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë) Lek pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Durrës për vitin 2026.

Argumentim:

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS
LIMIT TË KONTRATËS**

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve nr.260 e nr.8943 prot., datë 29.06.2026 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Specifikimeve Teknike si dhe Përllogaritjen e Fondit Limit, për procedurën e prokurimit me objekt: “Hartim Projekti “Plani i Mbarështimit të Pyjeve në Bashkinë Durrës”, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve për vitin 2026-2028.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit nëpërmjet dokumenteve:

- a. Sipas miratimit të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028.
- b. Objektin: Hartim Projekti “Plani i Mbarështimit të Pyjeve në Bashkinë Durrës.

I. PËRLLOGARITJA E VLERES LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës me objekt: “*Hartim Projekti “Plani i Mbarështimit të Pyjeve në Bashkinë Durrës”*”, duke u referuar në VKM-në nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullësor publik”, Manualin e Mbarështimit të Integruar të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr.864 prot., datë 30.01.2019. Të dhënat e kadastrës pyjore lidhur me përdorimin e territorit me volumet e fondit të pyjeve/kullotave, për ekonominë pyjore objekt i këtij prokurimi.

Mbështetur në rezultatin e sipër nxjerrë, rezultoi i se: Vlera e përgjithshme e kontratës për hartimin e planit të mbarështimit, për ekonomi të pyjore: “*Kodër Laç dhe Maminas*”, bazuar në të dhënat e këtyre ekonomive pyjore, sipas preventivave bashkëngjitur të jetë: 3,586,370 (tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të shërbimit do të jetë: brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve, nga nënshkrimi i kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;*
- b. *Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”, si dhe në përputhje me Dokumentet e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr.08, datë 23.09.2024.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, të *shtojcës 9*. (Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas *Shtojcës 10*.)

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 2 (dy) vitet e fundit financiare 2024, 2025, lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 2, germa c) e 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3, ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qenë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën*

procedurës. Kërkesa është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifën vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara për vitin 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, në nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025, përfshirë këstet e maturuara të vitit 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.*

Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është ligjërish i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.

Për sa i përket kapaciteteve teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat janë hartuar dhe vendosur nga struktura e posaçme e specializuar, sipas urdhrit Nr.260 e Nr.8943 prot., datë 29.06.2026, të titullarit të autoritetit kontraktor e si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit.

Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Shenim: Duke qenë se kemi të bëjmë me prokurim të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar me cilësi kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës bazuar në volumin e punës (dy ekonomi pyjore pranë njëra tjetrës), kompleksitetin në kryerjen e këtij shërbimi, rëndësinë dhe pjekurinë profesionale, duhet të kenë të punësuar si **staf teknik kryesor**, specialistë të profileve me eksperiencë pune në fushat respektive minimalisht 1 vit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për **3 mujorin e fundit**, në profesionet si më poshtë:

- 2 (dy) Specialiste Pyjesh (Inxhinier), të cilët do të jëtë dhe drejtuesit e grupit për secilën ekonomi pyjore në studim (Stafit teknik) të punës (të pajisur me "Çertifikate profesionale", për shërbime profesionale për projektme sipas germës (c) pika 1 neni nr. 3, e Rregullores nr. 3, datë 08.07.2009, "Për çertifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota") me përvojë në fushën e pyjeve dhe kullotave, Hartimin e Planeve të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, menaxhimit të tyre të qëndrueshëm, aspekteve Silvo-pastorale, të mbrojtjes dhe zhvillimit të burimeve natyrore, të ketë aftësi të mira organizative në grup etj. Përdor mirë teknologjinë në marrjen e të dhënave të terrenit dhe regjistrimin online të tyre, sipas programeve të miratuara.
- 2 (dy) Specialiste pyjesh/kullotash (Inxhinier) (nga një për secilën ekonomi pyjore) – të pajisur me "Çertifikate profesionale" në fushën e pyjeve dhe kullotave, me përvojë në punimet e terrenit për Hartimin e Planeve të Mbarështimit, përdorimin e teknologjisë në regjistrimin online të të dhënave dhe që njeh mirë territorin në studim.
- 2 (dy) Specialiste pyjesh /kullotash, (nga një për secilën ekonomi pyjore) - me përvojë në punimet e terrenit për Hartimin e Planeve të Mbarështimit dhe që njeh mirë territorin në studim (Inxhinier ose Teknik pyjesh).
- 1 (një) Specialist që njeh dhe përdor programet në GIS, ndarjen e ngastrave e n/ngastrave, përgatitjen e hartave të ndryshme sipas termave të referencës (dixhitalizimin, gjeoreferimin etj), përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave dixhitale (Inxhinier topograf/gjeodet/), i pajisur me Liçencë në fushën e projekteve (për sistemet GIS) kategoria 8-C, nga autoritetet kompetente ligjore.
- 1 (një) Pedolog
- 1 (një) Biolog
- 1 (një) Zootechnik
- 1 (një) Sociolog

Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve të stafit teknik/ekspertëve kryesorë që do të angazhohj në kryerjen e këtij studimi, do të duhet të vërtetohen nga ana e kontraktorit me dokumentat e mëposhtëme:

- *Kontratat individuale të punës* (të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës)
- *Diplomë*
- *Librezë pune*
- *CV-të, çertifikata kualifikimi, studime dhe/ose rekomandime.*

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në Manualin e Mbarështimit të Integruar të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 864 prot, datë 30.01.2019 “Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik” si dhe pikës 4, të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa b, të V.K.M nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që opertorët ekonomike të dëshmojnë që kanë stafin teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.3 Një punësim mesatar për tre muajt e fundit, i të paktën **11** (njëmbëdhjetë) personave të vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga drejtoria rajonale e tatimeve, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b. Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në Manualin e Mbarështimit të Integruar të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 864 prot, datë 30.01.2019 “Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik”, si dhe në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, germa b dhe c, të V.K.M nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Numri i kërkuar është i njëjtë në numrin e punonjësve të kërkuar si staf teknik kryesor, që konsulenti duhet të angazhojë në këtë shërbim. Me anë të këtij kriteri kërkohet që opertorët ekonomike të dëshmojnë që kanë personelin e kualifikuar inxhiniero teknik dhe fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen.

2.3.4 Për stafin kryesor të angazhuar, operatori duhet të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimit që ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 41, pika 4, germa d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që opertorët ekonomike të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për

realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion, të cilat janë si më poshtë vijon:

Lloji i mjetit/pajisjes	Sasia	Disponimi
Mjet transporti për personelin tip fuoristrade 4 x 4	2 copë	Pronësi/ose me qira
Aparat GPS	2 cope	Pronësi/ose me qira
Diameter mates	2 copë	Pronësi/ose me qira
Turjel per marrjen e kampioneve ne diameter	2 copë	Pronësi/ose me qira
Lazer meter (dstance meter)	2 copë	Pronësi/ose me qira
Pjerrresi mates+lartesi mates(Hypsometer) apo ekuivalent.	2 copë	Pronësi/ose me qira
Kompjuter dhe printera per punime zyre	2 copë	Pronësi/ose me qira
Busulla	2 copë	Pronësi/ose me qira
Meter shirit deri ne 20m	2 copë	Pronësi/ose me qira
Peshore per peshimin e barit	2 cope	Pronësi/ose me qira

a) Për mjetet që regjistrohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit. Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të paraqiten aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b) Për mjetet e siguruar me qira, dokumentet e mësipërme duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në Manualin e Mbarështimit të Integruar të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 864 prot, datë 30.01.2019 “Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik”, si dhe në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma ç, të V.K.M nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Këto pajisje kërkohen për dy grupe pune, pasi sipërfaqja e marrë në studim është e konsiderueshme (2 ekonomi pyjore), kjo e parashikuar në manualin e planeve të mbarështimit miratuar nga MTM. Me anë të këtij kriteri kërkohet që opertorët ekonomike të dëshmojnë që disponon mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike, për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të disponojë **certifikatat ISO**, ku në *fushën e certifikimit të jenë parashikuar shërbimet objekt prokurimi*, si më poshtë:

- a. SSH/EN-ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. SSH/EN-ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikata e mesiperme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe të ketë të specifikuara objektin e kontratës së prokuruar.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana

tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **Propozimin teknik (Planin e punës, përjasjen teknike dhe Metodologjinë)** për Hartimin e Planit të Mbarështimit (për Ekonomin/të Pyjore të ofertuar) i cili duhet të jetë në përputhje me termat e referencës dhe Udhëzuesin e integruar në fuqi për Hartimin e Planeve të Menaxhimit, kuadri logjik ku argumentohen objektivat, aktivitetet, aktorët, rezultatet e pritshme dhe indikatorët për realizimin me sukses të Planit të Mbarështimit. Subjekti mund të paraqesë dhe justifikojë ndonjë modifikim e përmirësim të Termave të Referencës duke përmirësuar performancën e kryerjes së shërbimit (*Këto sugjerime duhet të jenë konçize dhe me hollësi dhe mund të përfshihen në propozim*).

a. Plani i Punës. *Në të duhet të propozohen aktivitetet kryesore për kryerjen e shërbimit, përmbajtjen e tyre dhe kohëzgjatjen, shkalla dhe raportet, kohëzgjatjen (duke përfshirë periudhën kohore të miratimit nga autoriteti i ngarkuar me ligj), dhe datat e dorëzimit të raporteve. Plani i punës së propozuar duhet të jetë konsistent me përjasjen teknike dhe metodologjinë, të tregojë mirëkuptimin e Termave të Referencës dhe aftësinë e përkthimit të tyre në një plan pune të realizueshëm. Duhet të përfshihen këtu, një listë me dokumentat përfundimtar, duke përfshirë këtu edhe raportet, skicimet, dhe tabelat për tu paraqitur si outputet përfundimtare.*

b. Metodologjia dhe Përjasja Teknike. *Subjekti duhet të shpjegojë si i kupton ai objektivat e realizimit të këtij shërbimi, përjasja me shërbimet, metodologjinë për kryerjen e aktiviteteve dhe arritjen e outputeve të pritshme dhe shkallën e detajuar të këtyre outputeve. Duhet të theksojë problemet që do të adresohen dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përjasjen teknike që do të adaptojnë për ti adresuar ato. Gjithashtu duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adaptojnë dhe të theksojnë përputhshmërinë e këtyre metodologjive me përjasjet e propozuara.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Manualin e Mbarështimit të Integruar të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 864 prot, datë 30.01.2019 “Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik”, si dhe nenin nr. 45, pika 9, të V.K.M nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter do të shërbejë për vlerësimin e propozimeve teknike të dorëzuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës e cila është njëri nga komponentët për shpalljen e ofertës fituese, krahas asaj ekonomike.*

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Termet e referencës me të gjithë elementët përbërës janë hartuar dhe mbështetur në Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr.864 prot, datë 30.01.2019. Manuali përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat që duhet të plotësojë subjekti i kontraktuar gjatë fazës së punimeve të terrenit dhe ato të përpunimit të dhënave më pas në zyrë. Këto terma reference do të shërbejnë për të përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe kualifikimet e kërkuara për konsulentët që do të hartojnë Planin e Mbarështimit të Pyjeve për këtë ekonomi pyjore të Bashkisë Durrës

Në kuadër të reformës administrativo-territoriale, të ndërmarrë vitet e fundit, Bashkisë Durrës, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave e konkretisht V.K.M-në nr.134, datë 03.03.2021 *“Për disa ndryshime në vendimin nr.433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”*, i janë transferuar dhe kanë kaluar në pronësi sipërfaqet e fondit pyjor e kullor në territorin e kësaj bashkie. Nga 7 ekonomi pyjore që përfshihet fondi pyjor e kullor i Bashkisë Durrës këto ekonomi pyjore nuk kanë Plane Mbarështimi (të hartuara në vitet e fundit), 2 ekonomi janë në proces hartimi ndërsa të gjithë të tjerat kanë vetëm Plane Inventarizimi të hartuara në vite të ndryshme kohore nga ish komunat dhe bashkitë para reformës territoriale dhe për pasojë afati kohor i vlefshmërisë së tyre ka skaduar. Së fundmi duhet të theksohet fakti se mbështetur në ligjin 57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar, i cili sanksionon detyrimin e Njësisë të Qeverisjes Vendore (Bashkitë), për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave. Gjithashtu ç’do ndërhyrje në fondin pyjor/kullor duhet të bazohet tek rekomandimet e planeve të mbarështimit, brenda afatit të vlefshmërisë së tij (10 vjet).

Kujdes! Në termat e referencës, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët *“ose ekuivalente”*.

Termet e referencës dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Termat e referencës, preventivi, grafiku, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit